



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 380/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.06.2019 shqyrtoi ankesat me:

Objekt: “Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e shoqërive “Inpress” sh.p.k dhe “Rama Graf” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-10207-02-22-2019, me objekt: *“Botime, printime dhe materiale shtypshkrimesh” për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*, Loti III, me fond limit 12.698.122 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 20.03.2019 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.”

“Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e shoqërisë “Rama Graf” sh.p.k në procedurën e prokurimit.

Ankimues: “Albdesign PSP” sh.p.k
Rr. “Çerçiz Topulli”, Nr. 17, Kshar, Tiranë

“Rama Graf” sh.p.k
Lagja “5 Maji”, (pranë Ekonomikut), Elbasan

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë

Subjekte të Interesuar: “Inpress” sh.p.k
Ish Blloku i Magazinave të Tregtisë, Rruga Siri Kodra, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i

ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n :

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2 Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.02.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit me Nr.REF-10207-02-22-2019, me objekt: “*Botime, printime dhe materiale shtypshkrimesh*” për Qendrën Spitalore Universitare “*Nënë Tereza*”, Loti III, me fond limit 12.698.122 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 20.03.2019 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 04.04.2019 operatorët ekonomikë pjesëmarrës, janë njoftuar elektronikisht nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi klasifikimin e ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si vijon:

- | | |
|-------------------------|----------------------------|
| 1. “Rama - Graf” sh.p.k | 1730.00 lekë, kualifikuar |
| 2. “Inpress” sh.p.k | 5650.55 lekë, kualifikuar |
| 3. “Adel Co” sh.p.k | 6405.45 lekë, skualifikuar |

4. “Albdesing PSP” sh.p.k	6698.00 lekë, kualifikuar
5. “Kristalina KH” sh.p.k	6718.50 lekë, kualifikuar
6. “Dynamix Group” sh.p.k	7540.60 lekë, kualifikuar
7. “Shtypshkronja Morava” sh.p.k	7766.90 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 10.04.2019 operatori ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke pretenduar si vijon:

“Shoqëria “Inpress” sh.p.k dhe “Rama Graf” sh.p.k duhet të skualifikohen pasi:

Shoqëritë “Inpress” sh.p.k dhe “Rama Graf” sh.p.k kanë mangësi sepse mendojmë se nuk kanë paraqitur shtojcën 6 Deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe nuk kanë plotësuar atë edhe për administratorët dhe stafin tjetër sipas përcaktimeve ligjore në fuqi të përmirësuar së fundmi.

Cerifikata ISO 9001 nuk është sipas përcaktimeve të VKM dhe kriterit në dokumentat e tenderit, pasi shoqëritë “Inpress” sh.p.k dhe “Rama Graf” sh.p.k nuk e kanë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Bilancet e paraqitura të shoqërisë “Inpress” sh.p.k nuk janë të certifikuara pranë autoriteteve tatimore sipas kërkesës së DST, në pikën 2.2, pika 2 të DST shtojca 9.

Makineritë e paraqitura nga shoqëritë “Inpress” sh.p.k dhe “Rama Graf” sh.p.k nuk janë sipas specifikimeve të kërkuara në DST dhe nuk kanë dokumentacionin e duhur shoqëruës, pasi mungon dokumentacioni që vëreton disponimin për këto mjete sipas të gjitha përcaktimeve të kriterëve të bëra në DST.

Shoqëria “Inpress” sh.p.k nuk ka paraqitur dokumentin për të vërtetuar se ka shlyer të gjitha detyrimet në lidhje me energjinë elektrike sipas ekstraktit të QKR.

Shoqëritë “Inpress” sh.p.k dhe “Rama Graf” sh.p.k nuk vërtetojnë se plotësojnë kriterin për kontrata të ngjashme. Kanë mangësi në dokumentacion dhe nuk e kanë paraqitur atë sipas kriterit në DST.

II.3.1. Nëpërmjet shkresës nr. 644/1 prot., datë 17.04.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje shoqërisë “Albdesign PSP” sh.p.k, duke e refuzuar ankesën.

II.3.2. Në datën 26.04.2019, pala ankimuese “Albdesign PSP” sh.p.k, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.3.3. Në datën 14.05.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 766/2 prot., informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.4. Në datën 23.04.2019 autoriteti kontraktor ka bërë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në SPE, si më poshtë vijon:

1. “Rama - Graf” sh.p.k	1730.00 lekë, skualifikuar
2. “Inpress” sh.p.k	5650.55 lekë, kualifikuar
3. “Adel Co” sh.p.k	6405.45 lekë, skualifikuar
4. “Albdesing PSP” sh.p.k	6698.00 lekë, kualifikuar
5. “Kristalina KH” sh.p.k	6718.50 lekë, kualifikuar
6. “Dynamix Group” sh.p.k	7540.60 lekë, kualifikuar
7. “Shtypshkronja Morava” sh.p.k	7766.90 lekë, kualifikuar

Operatori ekonomik “Rama Graf” sh.p.k është njoftuar elektronikisht për skualifikimin e tij me argumentin:

“Në bazë të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nr. 645/1 datë 15.04.2019, operatori ekonomik nuk ka ofertuar në formularin e ofertës për Artikullin nr. 172 “fishë për sherbimin e urgjencës së sëmundjeve të brendshme” dhe nr. 173 “bllok për paaftësinë të përkohshme në punë (bllok me 100 fletë).”

II.5. Në datën 25.04.2019 operatori ekonomik “Rama Graf” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si më poshtë vijon:

“Pasi u njohëm me vlerësimin e dytë nga ana e autoritetit kontraktor me datë 23.04.2019, nëpërmjet mesazhit elektronik ku firma Rama Graf është skualifikuar për mos pasqyrim në formularin e ofertës për artikujt me nr. rendor 172 dhe 173, ju sqarojmë se artikujt 172, 173 janë ofertuar me cmimin 0 lekë për arsye se i kemi gjëndje nga puna e mbartur me autoritetin kontraktor QSUT, me të cilin kemi patur kontratë dy vitet e fundit dhe do t’ia dhuroj këtij autoriteti QSUT pa pagesë. Për këtë arsye këto dy artikuj janë pasqyruar në shtojcën e sasisë dhe grafikut të lëvrimit sipas DT pa vlerë.

- *Nuk ka ndikuar në renditjen përfundimtare pasi këto artikuj janë ofertuar me cmimin 0 lekë dhe shumatorja e cmimit për njësi nga operatori i parë Rama Graf 1730.00 dhe i dyti “Inpress” 5650.55.*
- *Nuk ka dëm ekonomik për autoritetin kontraktor.*
- *Operatori ekonomik është dakort me furnizimin e AK për artikujt 172-173, mbasi kjo është pasqyruar dhe në shtojcën e sasisë dhe grafikut të lëvrimit të dorëzuara bashkë me ftesën për ofertë*
- *Firma “Rama Graf” sh.p.k ka një përvojë mbi 20 vjecare në fushën e botimeve dhe të shtypshkrimeve. Gjatë kësaj periudhe i ka realizuar me sukses të gjitha kontratat pa patur në asnjë rast ankimim nga autoritetet kontraktore. Edhe në rastin e AK QSUT kemi realizuar 2-3 vitet e fundit kontratat me sukses, e konfirmuar kjo nga vërtetimet që ky autoritet ka dhënë. Kjo është pasqyruar edhe me kontratat e njëjta që i kemi bashkëngjitur në DT.*

Kjo tregon seriozitetin e kësaj firme ku jemi të aftë të realizojmë kontratën sipas të gjithë artikujve të përcaktuara tek sasia dhe grafiku i lëvrimit. Kërkojmë nga KVO që të rishikojë vlerësimin e bërë në datën 23.04.2019 ku operatori ekonomik “Rama Graf” sh.p.k është skualifikuar dhe të zbatojë vlerësimin e datës 04.04.2019 në të cilën kjo firmë është kualifikuar.”

II.5.1. Nëpërmjet shkresës nr.746/2 prot., datë 02.05.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit duke e refuzuar ankesën.

II.5.2. Në datën 08.05.2019 operatori ekonomik “Rama Graf” sh.p.k ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor. Gjithashtu ngrihen pretendime për ankesën e operatorit ekonomik “Inpress” sh.p.k në autoritetin kontraktor. Së fundi, pretendohet se autoriteti kontraktor nuk i ka kthyer përgjigje brenda afateve ligjore.

II.5.3. Në datën 10.06.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 824/2 prot., informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre si dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Rama Graf” shpk se: “operatori ekonomik nuk ka ofertuar në formularin e ofertës për Artikullin nr. 172 “fishë për sherbimin e urgjencës së sëmundjeve të brendshme” dhe nr. 173 “bllok për paaftësinë të përkohshme në punë (bllok me 100 fletë)”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 1 “Formulari i ofertës ekonomike”, në pikat 172 dhe 173 autoriteti kontraktor ka parashikuar si vijon:

Shtojca 1

[Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Loti III. “Botime, printime dhe materiale shtypshkrimesh” për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, fondi limit i marrëveshjes kuadër për këtë lot është 12,698,122 (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e teteë mijë e njëqind e njëzet e dy) lekë pa TVSH.

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

** * **

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-së

** * **

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

1	2	3	4	5
Nr	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Çmimi Njësi	Afati
.....	[...]			
172	Fishe per sherbimin e Urgjences se semundjeve te brendeshme	copë		
173	Bllok per paaftesine te perkoheshme ne pune (bllok me 100 flete	cope		
	Shumatorja limit e çmimeve për njësi (në LEK) Pa TVSH		7,918.8	

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (kërkuar në dokumentat e tenderit)

III.1.2. Në Shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 1, gërma “ç”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

“1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

ç. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);”

III.1.3. Në shtojcën 10 “Specifikimet teknike”, për artikujt objekt ankese është kërkuar si vijon:

Shtojca 10

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

Loti III: “Botime, printime dhe materiale shtypshkrimesh” për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”,

SPECIFIKIMET TEKNIKE

172. Kartele (Fishe) per Urgjencen e Semundjeve te brendeshme- Leter A4, e shtypur si mostra me pese flete. Malli te jete i etiketuar dhe i ambalazhuar.

173. Bllok per paaftesi te perkoheshme ne pune (bllok me 100 flet) - Bllok Blllok per paaftesi te perkoheshme ne pune(bllok me 100 flet), shtypur si mostra. Malli te jete I paketuar dhe I ambalazhuar

Në shtojcën 12 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit” është parashikuar:

Shtojca 12

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Për Lotin III. “Botime, printime dhe materiale shtypshkrimesh” për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”

Sasia si më poshtë:

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia e pritshme</i>
172	<i>Fishe per sherbimin e Urgjences se semundjeve te brendeshme</i>	<i>copë</i>	35000
173	<i>Bllok per paaftesine te perkoheshme ne pune (bllok me 100 flete</i>	<i>cope</i>	600

Grafiku i levrimit:

Duke filluar nga data e lidhjes së kontratës/kontratave me përfundim deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor sipas marrëveshjes kuadër.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”*

III.1.4. Në rastin konkret, nga verifikimi i Formularit të ofertës ekonomike të paraqitur nga ankimuesi, konstatohet se ky formular nuk është plotësuar sipas kërkesave të autoritetit kontraktor të publikuar në dokumentat e tenderit, pasi në të mungojnë zërat 172 “Fishe per sherbimin e Urgjences se semundjeve te brendeshme” dhe 173 “Bllok per paaftesine te perkoheshme ne pune (bllok me 100 flete)”.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, përfituesi i drejtëpërdrejtë i mallit të kërkuar, është autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për përzgjedhjen e ofertuesit më të leverdisshëm si dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 62 të LPP “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”.

III.1.6. Referuar nenit 53, pika 3 dhe 4 të LPP-së, ku përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj”*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se oferta ekonomike, paraqitur nga shoqëria “Rama Graf” sh.p.k nuk është paraqitur sipas përcaktimeve të bëra në Formularin e Cmimit të Ofertës, pasi në të mungojnë dy zera , tregues i cili vërteton se kjo ofertë nuk është e rregullt pasi evidentohet shkelje e atij karakteri që konsiderohen haptazi në kundërshtim me ligjin, e tillë që të ndikojë në mirëpërdorimin e fondeve publike.

Mospërfshirja e dy artikujve në ofertën ekonomike e bën automatikisht ofertën e ankimuesit të papranueshme në kuptim dhe të nenit 1 dhe 2 të LPP i cili parashikon se : *“Qëllimi i këtij ligji është:*

[...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”;

“Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;

b) transparencë në procedurat e prokurimit;

c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”,

Komisioni gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt ankimi.

Për sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik “Rama Graf” shpk nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k për shoqërinë “Rama Graf” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar argumentimit të dhënë më sipër në pikën III.1. të arsyetimit, gjykon se gjendja e faktike juridike e shoqërisë “Rama Graf” sh.p.k pas arsyetimit të K.P.P. do të mbetet e skualifikuar, ndaj dhe shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k se: “Makinëritë e paraqitura nga shoqëria “Inpress” sh.p.k nuk janë sipas specifikimeve të kërkuara në DST dhe nuk kanë dokumentacionin e duhur shoqëruar, pasi mungon dokumentacioni që vërteton disponimin për këto mjete sipas të gjitha përcaktimeve të kritereve të bëra në DST”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e Vecata të Kualifikimit” ”Kapaciteti Teknik”, pika 2, përcaktohet kriteri si më poshtë:

“Operatori ekonomik për të vertetuar që ka kapacitetet teknike për të ekzekutuar kontratën, duhet të disponojë pajisjet e mëposhtme

- Minimumi një makinë shtypi me format min 50cm X 70 cm;
- Minimumi një makinë qepëse;
- Minimumi një makinë telefoni;

Operatori ekonomik, për të vertetuar se i disponon këto tre pajisje, duhet të paraqesë dokumentacionin në një nga format e mëposhtme:

- Kontrate shitblerje/ Fature shitblerje, ose
- Kontrate huapërdorje, ose
- Kontrate qiramarrje, ose
- kontrata e dhurimit;”

III.3.2. Nëpërmjet shkresës nr. 644/1 prot., datë 17.04.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje shoqërisë ankimuese, duke e sqaruar për pretendimin e mësipërm si vijon:

“Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi verifikoi dokumentat e tenderit, procesverbalin e mbajtur nga komisioni i vlerësimit të ofertave, lidhur me procedurën e vlerësimit dhe dokumentat e dorëzuara nga ofertuesi “Inpress” sh.p.k për këtë procedurë në SPE, konstatoi se ofertuesi “Inpress” sh.p.k ka dorëzuar në në sistemin e prokurimit elektronik, si pjesë të ofertës së tij, edhe faturë tatimore shitje, vendim për shpalljen e fituesit të ankandit, mandat arkëtimi, formular transferte bankare si dhe kopje të certifikuar të bilancit të vitit 2017, të nënshkruar dhe të vulosur nga institucioni përkatës tatimor, të shoqëruar me shkresën e autoritetit përkatës tatimor që konfirmon paraqitjen e tij. Në zërin “Aktivet afatgjata materiale”, të pasqyrave financiare, rezultojnë të deklaruara dhe konfirmuara nga tatimet, në pronësi të “Inpress” sh.p.k, ndër të tjera edhe pajisjet 1) makinë shtypi me format 50cm x 79 cm; 2) makinë qepëse; 3) makinë celefoni. Nga tërësia e dokumentacionit të dorëzuar nga ofertuesi “Inpress” sh.p.k, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka arritur të krijojë bindjen, bazuar edhe në pikën 4 të nenit 53 të LPP-së se ky ofertues i disponon pajisjet minimale të kërkuara në DST dhe të domosdoshme për realizimin e kësaj procedure.”

III.3.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se në përmbushje të kriterit sa më sipër cituar, operatori ekonomik “Inpress” shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Për kërkesën e AK *“Minimumi një makinë shtypi me format min 50cm X 70 cm”*, operatori ekonomik “Inpress” shpk ka paraqitur kopje të bilancit të vitit 2017, të konfirmuara nga administrata tatimore, ku në pasqyrën *“Aktive afatgjata materiale për vitin 2017”* evidentohet e pasqyruar makineri offset 50 X 70, 2 copë.
- Për kërkesën *“Minimumi një makinë celefoni”* operatori ekonomik “Inpress” shpk ka paraqitur kopje të bilancit të vitit 2017, të konfirmuara nga administrata tatimore, ku në pasqyrën *“Aktive afatgjata materiale për vitin 2017”* evidentohet e pasqyruar makinë paketim ambalazhi celofan 1 copë.
- Për kërkesën e AK *“Minimumi një makinë qepëse”*, operatori ekonomik “Inpress” shpk ka paraqitur:
 1. Vendimin për shpalljen e fituesit të ankandit nr. 737.Dosje/Nr.1321.Prot, datë 24.05.2018 nga Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë. Sipas këtij vendimi shoqëria “Inpress” sh.p.k është shpallur si fitues i makës qepëse me tel tip “886”- MULLER MARTINI.
 2. Faturë tatimore shitje datë 23.05.2018.
 3. Mandat arkëtimi
 4. Formular urdhër transferte.

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative,

reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një 7 ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*”.

III.3.4. Referuar sa më sipër KPP konstaton se në kriterin e kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht: *operatori ekonomik, për të vërtetuar se i disponon keto tre pajisje, duhet të paraqesë dokumentacionin në një nga format si vijon: Kontrate shitblerje/ Fature shitblerje, ose Kontrate huapërdorje, ose Kontrate qiramarrje, ose kontrata e dhurimit.* Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Inpress shpk KPP vëren se për makinën qepëse është paraqitur vendimi i ankandit, shoqëruar me faturë tatimore dhe dokumentacion plotësues që vërteton pagimin e vlerës së ankandit, në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Përsa i përket kërkesës së autoritetit kontraktor për minimumi një makinë shtypi me format min 50cm X 70 cm dhe minimumi një makinë telefoni, operatori ekonomik “Inpress” shpk ka paraqitur kopje të bilancit të vitit 2017, ku në pasqyrën “Aktive afatgjata materiale për vitin 2017” evidentohet e pasqyruar makineri offset 50 X 70 dhe makinë paketim ambalazhi celofan. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se *komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit,* Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ”Inpress” shpk nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur dokumenta provues në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit përsa i përket makinerisë së shtypit me format min 50cm X 70 cm dhe makinës së telefonit. Paraqitja e bilancit të vitit 2017, nuk është dokumenti i kërkuar dhe i gjykuar nga autoriteti kontraktor si i nevojshëm për të vërtetuar disponimin e tyre, sic parashikohet në nenin 46, pika 1 të LPP-së.

III.3.5. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.3.6. Gjithashtu, Komisioni sqaron se nëse operatori ekonomik ”Inpress” shpk do të kishte pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit ka

patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimin të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“ [...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*.

Përsa më sipër, pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Albdesign PSP” shpk për kualifikimin e padrejtë të shoqërisë “Inpress” sh.p.k në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e trajtuara më sipër në pikën III.3. të arsyetimit qëndrojnë dhe gjendja faktike juridike e shoqërisë “Inpress” sh.p.k, pas arsyetimit të K.P.P do të ndryshojë duke u skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të ankimuesit në fjalë nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij subjekti e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr.REF-10207-02-22-2019, me objekt: “*Botime, printime dhe materiale shtypshkrimesh*” për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Loti III, me fond limit 12.698.122 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 20.03.2019 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rama Graf” sh.p.k për procedurën e prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Inpress” sh.p.k, duke e skualifikuar atë.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
6. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albdesign PSP” shpk
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 766 Protokolli;

Datë 26.04.2019

Nr. 824 Protokolli;

Datë 08.05.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha